



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 01-597/16
Bi Prot. 02
Prot No. 02
Data 12.02.2016
Date 12.02.2016
PRISHTINE

DATË/A:	12/02/2016
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	z. Isak KEROLLI Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës
CC:	z. Arben GJUKAJ Drejtor Menaxhues në Korporatën Energjetike të Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: "Ndërrimi i shtratit sferik me kurorën e dhëmbëzuar në Makinën e Kombinuar II"

I nderuar z. Kerolli,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin "Ndërrimi i shtratit sferik me kurorën e dhëmbëzuar në Makinën e Kombinuar II" me numër prokurimi: KEKC 16 042 511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejshëm A.K), që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Ndërrimi i shtratit sferik me kurorën e dhëmbëzuar në Makinën e Kombinuar II" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Korporata Energjetike e Kosovës, si Autoritet Kontraktues ka përgatit Njoftimin për Kontratë me titull: "**Ndërrimi i shtratit sferik me kurorën e dhëmbëzuar ne Makinën e Kombinuar II**" me numër prokurimi: KEKC 16 042 511. Ky aktivitet i prokurimit më datë 26/01/2016 është publikuar në web faqen e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nga Dosja Tenderit. Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Dosjen e Tenderit me titull "**Ndërrimi i shtratit sferik me kurorën e dhëmbëzuar ne Makinën e Kombinuar II**", në SEKSIONI II, FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT, tek pika 9.1 Kapaciteti teknik dhe profesional, nënpika 1, kërkohet që: *Së paku një referencë në realizimin e projekteve të ngjashme në vlerë prej minimum 500,000.00€ në 3 vitet e fundit. Të dëshmohet me referencë të lëshuar nga punëdhënësit për kryerjen me sukses të projektit.* Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj që Operatori Ekonomik të ketë realizuar punët e natyrës së ngjashme me natyrën e punës që zhvillohet aktiviteti i prokurimit, edhe atë mund ta kërkoj për periudhën e tre viteve të fundit duke i vendosur edhe një vlerë të caktuar të referencave, por në asnjë mënyrë të caktohet vlera e caktuar për një referencë me vlerë konkrete. Në këtë rast që është kërkuar së paku se paku një referencë në vlerë prej 500,000.00 €, Agjencia konsideron se ky është kriter diskriminues dhe si i tillë nuk i lë hapësirë konkurrencës së lirë të tregut.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, si dhe Nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; dhe Pikën 23, Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !